

KOHA

red rain

ENERGY DRINK





BALLINA LAJME KRONIKË KULTURË SPORT MES VËSHTRIME HOROSKOPI COVID-19 FJALËKRYQ VIDEO ARKIVI SHPALLJE PERKUJTIME

KOHA DITORE

> Gjendet trupi i tretë pas rrëshqitjes së dheut në Norvegji, shtatë të tjerë mbeten të zhdukur
13 MINUTA MË PARË

> Tërmet tjetër në Kroaci, 3.5 ballë Rihter
40 MINUTA MË PARË

> Valladolidi mposht Getafen
47 MINUTA MË PARË

5°

TOP KOHA MUSIC

59

Cilësia e ajrit në Prist

: Cut Bank (10+) • 02:30 Film: Shënimi i fshehtë (10+) • 04:15 Film: Kampi X-Ray (10+) • 06:00 Jeta Festive - r • 06:3

5 të arrestuar



Policia e Mirditës ka arrestuar pesë persona dhe ka sekuestruar armë, drogë dhe municion luftarak.

Në zbatim të planit të masave për shtimin e kontrolleve në të gjithë territorin e qarkut Lezhë, me qëllim parandalimin, evidentimin dhe goditjen e paligjshmërisë, nga Policia e Mirditës, në bashkëpunim me Seksionin për Hetimin e Narkotikëve në DVP Lezhë, u organizua dhe finalizua operacioni policor i koduar “Bulshar”, si rezultat i të cilit u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve: J. N .,28 vjeç, F. Rr., 27 vjeç, K. L., 29 vjeç, N. Rr., 28 vjeç dhe N. L., 59 vjeç, të gjithë banues në fshatin Bulshar, Mirditë.

Shërbimet e Policisë, pas informacioneve të marra në rrugë operative se këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin po përgatishnin një sasi lënde narkotike në doza të vogla, për ta shpërndarë, kanë ushtruar kontroll në vendin ku ata qëndronin, një godinë e braktisur, në fshatin Bulshar. Si rezultat, Policia ka sekuestruar sasinë e lëndës narkotike dhe ka arrestuar 5 shtetasit e lartpërmendur.

Gjithashtu gjatë kontrollit të ushtruar në banesat e këtyre shtetasve, në banesën e shtetasit K. L. , u gjet dhe u sekuestrua një armë zjarri kallashnikov, me 30 fishekë. Në vijim të veprimeve, Policia arrestoi në flagrancë shtetasin N. L., 59 vjeç, banues në Bulshar, Mirditë.

Materialet iu referuan prokurorisë për veprime të mëtejshme, për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” në ngarkim të shtetasit J. K. për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, për shtetasit F. RR., K.L dhe N. RR., si dhe për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve të zjarrit dhe municionit luftarak” në ngarkim të shtetasit N. L.

25 tetor 2019, 09:52

Shpërndaje në



Like 0 Share